

VENDIM
Nr. 2, datë 19.1.2018

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME HIMARË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë me:
Drejtues ligjor: Andrea Goro
Drejtues teknik: Fatjon Beqiraj.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Himarë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të kësaj shoqërie janë njësitë administrative Himarë dhe Lukovë (Bashkia Himarë)
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare (njëvjeçare). Brenda këtij afati kohor shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Himarë duhet të përfshijë në zonën e shërbimit edhe njësinë administrative Horë-Vranisht.

KRYETARI
Ndriçim Shani